



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT PERGJITHSHEM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit. 21. 3. 1-2008-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË MINISTRISË
SË TREGTISË DHE INDUSTRIË
PËR FUND VITIN 31 DHJETOR 2008**

Prishtinë, 27 Korrik 2009

Tabela e përmbajtjes

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e MTI-së dhe përgjigja e ZAP për Komete

Lista e shkurtesave

AB	Auditori i brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
LMFPP	Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Nr. 2003/17 Për Prokurimin Publik në Kosovë Me ndryshimet dhe plotësimet e datës 8 shkurt 2007
LVTH	Llogaria Vetme e Thesarit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OB	Organizatrat Buxhetore
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
PF	Pasqyrat Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UA	Udhëzimi Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne i kemi vlerësuar si të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Për mendimin tonë, pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale. Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen për faktin se Pasuritë fikse nuk janë shpalosur në Pasqyrat Financiare (ISSAI 400 *Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes*).

Auditimi ynë ka shpalosur disa mangësi që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm:

1. Procedurat e prokurimit lidhur me shpenzimet të përcaktuara me LPP dhe rregulla tjera në fuqi nuk zbatohen në tërësi.
2. Mos klasifikim i të hyrave sipas regjistrave të MTI-se, si dhe mos harmonizimi në mes të të dhënave të departamenteve, regjistrave të bankës dhe librit kryesor të Departamentit të Thesarit.
3. Menaxhimi i pasurive nuk është bërë në mënyrë adekuate. Ka mangësi në krijimin e evidencave të mirëfillta në lidhje me materialet furnizuese të zyrës.
4. Pagesa të stafit edhe pas skadimit të kontratës, pas vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, si dhe gjatë kohës së pushimit pa pagesë.
5. Te Obligimet e pa paguara të prezantuara në PF ka vonesa të pa arsyeshme në kryerjen e pagesave.
6. Gjatë vitit 2008, MTI nuk kishte arritur që ta ketë të konsoliduar sa duhet NjAB, pasi që nga Marsi deri në Qershor NjAB kishte mbetur pa Auditor të Brendshëm, prandaj NjAB nuk ka mundur që në mënyrë të mjaftueshme të përmbushë funksionin e tij.

Çështjet e përmendura më lartë flasin për një performancë jo të kënaqshme të sistemit të kontrollit, të cilat më gjerësisht do të trajtohen në kapitullin VII të këtij raporti.

Rekomandimi ynë kryesor është që, Ministri duhet të forcoj sistemin e kontrollës së brendshme, që siguron atij një bazë solide për menaxhim të fortë financiar dhe informata të besueshme financiare dhe operative .

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato t’i prezantoj me kohë.

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2007 kishte dhënë 14 rekomandime. MTI nuk ka përgatitë një plan veprimi për implementimin e këtyre rekomandimeve, madje menaxhmenti i lartë nuk i ka informuar fare drejtuesit e departamenteve në lidhje me këtë raport të dërguar nga ZAP me datën 27.02.2009.

Rekomandimet kyçe të pa adresuara nga vitit i kaluar:

- Të krijoj regjistra kontabël dhe në mbështetje të këtyre regjistrave të përgatis pasqyrat financiare.
- Të krijohen dëshmi të dokumenteve burimore të taksës rrugore, përfshirë sistemin e fletëpagesave të inkasimit me emër dhe pronësi të MTI-së. Po ashtu është rekomanduar që Departamenti i Tregtisë të disponojë me evidenca të mirëfillta në lidhje me këto të hyra si të hyra kryesore të MTI-së
- Duhet sa më parë të merr masa adekuate që të siguroj pajtueshmëri të plotë me UA nr. 2005/11 duke i mirëmbajtur në mënyrë të duhur regjistrat e pasurisë, të siguroj pastaj se

është kryer një inventarizim vjetorë për të gjitha pasuritë, dhe në përgjithësi të siguroj se gjithçka është në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Ligjit 2003/2- Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe instrumenteve të tjera relevante ligjore.

- Departamenti i prokurimit të MTI-së duhet të ushtroj kontroll të fuqishëm në zbatueshmërinë e kërkesave të LPP-së, si në procedurat e zhvillimit të aktivitetit prokurues ashtu edhe në përmbushjen e kontratave.

Konkluzion

Mos ndërmarrja e veprimeve konkrete për zbatimin e rekomandimeve tona është një indikator i fortë se dobësitë e raportuara me herët mund të ekzistojnë edhe më tutje.

IV. Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim i MTI ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të MTI, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiarë, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

V. Qasja e auditimit

Auditimi ynë është planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 20 prill 2009 deri më 03 qershor 2009, në bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të MTI në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008.
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të MTI janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".
3. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në MTI, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të MTI, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

VI. Opinioni i auditimit

Për mendimin tonë, pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale. Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen për faktin se Pasuritë fikse nuk janë shpalosur në Pasqyrat Financiare (ISSAI 400 *Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes*).

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Shpenzimet e përgjithshme të paguara në vitin 2008 ishin €3,969,000 ndërsa obligimet e mbetura të bartura për tu paguar në vitin 2009 ishin €48,644 .

Krahasuar me buxhetin e aprovuar në vlerë prej €5,745,138 Ministria kishte shpenzuar rreth 69% të buxhetit të planifikuar dhe në fund të vitit 2008 kishte një suficit prej €1,776,000 . Suficiti më i lartë paraqitet te kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve, ku buxheti i aprovuar për këtë kategori, pas rishikimit të buxhetit, ka qenë €1,571,688 ndërsa shpenzimet e ndodhura €896,045 çka d.m.th se 43 % na paraqitet suficit.

Të hyrat e mbledhura nga burimet vetjake për vitin 2008 ishin rreth €2,376,707 ndërsa të planifikuara ishin €2,103,700 . Kjo tregon se MTI ka pasur një performancë të mirë në planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave vetjake. (Për më shumë, shih: “Kapitulli 3.1 – Të hyrat”)

Konkluzioni

Sipas vlerësimit tonë Ministria kishte shpenzuar buxhetin për vitin 2008 në kuadër të limiteve të përcaktuara nga Kuvendi me rastin e aprovimit të Buxhetit për vitin 2008. Por shkalla e shfrytëzimit të buxhetit prej vetëm 69% flet për dobësi substanciale në planifikimin e tij, apo, në të kundërtën, për një mos efikasitet në aktivitetet operative.

2. Pasqyrat financiare

MTI nuk kishte arritur që të bëjë regjistrimin dhe mirëmbajtën e të gjitha pasurive gjatë vitit në përputhje me IA 2005/11. Në mungesë të këtyre evidencave të plota, MTI nuk ka arritur që të prezantojë pasuritë në Pasqyrat Financiare të vitit 2008.

Konkluzioni

Mos shpalojja e Pasurive në PF bie ndesh me UA nr. 2008/13 mbi raportimin e plotë të të gjitha pasurive jo financiare.

Rekomandimi nr. 1

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj :

- Raportimin e saktë të PF në përputhje me regjistrat kontabël dhe Udhëzimet administrative që nxirren çdo vit nga MEF, ku duhen të përfshihen të gjitha informatat relevante, përfshirë pasuritë.

3. Realizimi i Buxhetit

3.1 Të Hyrat

Të hyrat vetjake në Ministrinë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2008 kanë qenë €2,376,707 .

Të hyrat kryesore të arkëtuara gjatë vitit kanë qenë nga:

- Departamenti i Tregtisë
- Zyra për Pronësi Industriale

Për mendimin tonë saktësia e shifrës së të hyrave në pasqyrat financiare është e paverifikueshme. Shembujt e mosharmonizimit të shumave janë paraqitur me poshtë:

3.1.1 Të hyrat nga Departamenti i Tregtisë

Tabela nr.1: Të hyrat

Kodi ekonomik	Përshkrimi i Kodit Ekonomik	Sipas Dep. të. Tregtisë (€)	Sipas SIMFK (PF) (€)	Diferencat (€)
50301	Import i përgjithshëm	28,600	63,150	-34,550
50302	Import i vajrave	2,200	0	2,200
50303	Import i LPG	5,000	0	5,000
50305	Import i Mazutit	2,000	0	2,000
50306	Import i Vajit Solar	2,000	0	2,000
50307	Import i Naftës Industr.	2,000	0	2,000
50308	Shitje me pakicë	21,250	39,850	-18,600
50309	Shitje me shumice	17,700	6,400	11,300
50310	Shitja e LPG	3,000	5,250	-2,250
50311	Shërbime (vajra)	1,950	4,100	-2,150
50313	Deponim	6,050	6,400	-350
-	Të pa specifikuara	31,350	-	31,350
Totali		123,100	125,150	-2,050

Të gjeturat:

- Nga Tabela nr. 1 shihet se është bërë regjistrimi i të hyrave në mënyrë të gabuar në SIMFK (librin kryesor), kur e krahasojmë me evidencat e krijuara sipas MTI-se, si dhe na paraqitet një shumë prej €31,350 në regjistrat e MTI-së, e cila nuk dihet se cilës kategori të të hyrave i takon.
- Prezantimi i të hyrave në PF është bërë sipas evidencave të SIMFK (librit kryesor) e jo sipas shënimeve burimore.

3.1.2 Të hyrat nga Zyra për Pronësi Industriale:

Këto të hyra janë të rregulluara sipas UA 2007/19. Të hyrat sipas PF kanë qenë €632,115, ndërsa sipas raportit vjetor të zyrtares së të hyrave €540,330. Diferenca e paraqitur prej €91,785 vjen si rezultat i mos harmonizimeve midis të hyrave të raportuara nga bankat komerciale, Thesari (SIMFK), BQK dhe dokumentacionit burimor.

Konkluzion

Mos klasifikimi i të hyrave sipas kodeve përkatëse në regjistrat e MTI-së, dhe në librin kryesor, si dhe diferencat e paraqitura si rezultat i mos harmonizimeve të të hyrave ndikojnë në uljen e besueshmërisë së të hyrave të prezantuara në PF, dhe tregon për mangësitë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi nr. 2

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj:

- Klasifikimin e të gjitha të hyrave sipas kodeve të sakta ekonomike, të përcaktuara nga Departamenti i Thesarit
- Barazimet mujore në mes të të dhënave të departamenteve, regjistrave të bankës dhe librit kryesor të Departamentit të Thesarit. Çdo diferencë e identifikuar duhet të zgjidhet

3.2 Pagat dhe Mëditjet

Buxheti për kategorinë Paga dhe Mëditje për vitin 2008 ka qenë €553,000 derisa shpenzimet aktuale për paga gjatë vitit 2008 ishin €501,000. Suficiti për vitin 2008 nga kategoria Paga dhe Mëditje është €53,000. Mesatarja e numrit të punëtorëve ka qenë 154.

Gjate auditimit ne kemi bërë testimin e 9 (nëntë) dosjeve të personelit, të punëtorëve të pranuar dhe të larguar nga puna gjatë vitit 2008.

Të gjeturat:

Në katër raste kemi gjetur se janë bërë pagesa të Pagave në vlerë prej 547 €, pa marr parasysh se:

1. Kontrata kishte skaduar me datën 22.12.2007 kurse i punësuari ishte paguar deri me datën 16.01.2008.

2. Në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 25.08.2008, thuhet se pas skadimit të pushimit vjetor me datë 15.08.2008, i punësuari nuk ishte lajmëruar në punë deri me 22.08.2008, duke mos i arsyetuar mosardhjet. I njëjti ishte paguar për tërë muajin Gusht.
3. Është bërë pagesa për tërë muajin korrik, në kohën kur punëtori kishte qenë në pushimin pa pagesë (2 mujor) prej 13.07.2008 deri 13.09.2008.
4. Punëtori ka pasur kontratë të përkohshme, ndërsa ka pranuar pagën nga kategoria e Pagave dhe Mëditjeve. I njëjti ka fituar statusin e punëtorit të rregullt me datën 12.06.2008. Po ashtu ky punëtorë nga data 01.06.2008. deri me 12.06.2008 ka pranuar pagën pa pasur kontratë.

Konkluzioni

Nga gjetjet e mësipërme rezulton se MTI ka bërë pagesa të pa autorizuar për paga dhe mëditje. Kjo është pasojë e kontroleve të brendshme jo adekuate, dhe si pagesa jo të rregullta dëmtojnë buxhetin e Kosovës. Po ashtu përfshirja në listën e Pagave dhe Mëditjeve përmes shërbimeve të kontraktuar, bie ndesh me rregullat mbi Shërbimin Civil të Kosovës, dhe si të tilla i paraprijnë legjitimitetit të vendeve të punës.

Rekomandimi nr. 3

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj :

- Të gjitha pagesat e kryera pa mbështetje ligjore, duhet t'i kthehen MTI-së.
- MTI duhet të forcoj kontrollet mbi pagesat dhe evidencat mbi personelin.
- Të mos shfrytëzohen forma të parregullta të arritjes së statusit të rregullt të marrëdhënies së punës, që bien ndesh me rregullat e Shërbimit Civil të Kosovës.

3.3. Prokurimi

Gjatë vitit 2008 MTI kishte ndërmarrë rreth 108 aktivitete prokurimi të llojeve të ndryshme, në vlerë totale prej €2,585,113. ZAP ka audituar 6 aktivitete, të përzgjedhura sipas gjykimit profesional në vlerë prej €1,842,458 nga të cilat një (1) përfshinë investimet kapitale, ndërsa pesë (5) të tjera për mallra dhe shërbime.

Shpenzimet e Materialeve furnizuese te zyrës

Për këtë kategori shpenzimesh kemi ekzaminuar një mostër gjykimi prej dy artikujve: Tonerit dhe Letrës

- MTI gjatë vitit 2008 ka shpenzuar për blerje të Tonerit dhe Letrës €25,756. Vetëm për blerje të Letrës janë shpenzuar €7,582 e shprehur në sasi: 2641 Risë (1 Risë 500 faqe) apo 1,320,500 faqe. Në raport me mesataren e numrit të Punëtorëve, MTI ka shpenzuar gjatë vitit 8575 faqe për Punëtor.
- Zyrtari i pranimit të materialeve furnizuese nuk kishte krijuar evidenca të qarta, në lidhje me hyrjet dhe daljet e këtyre materialeve, ku nuk dihej as saldo fillestare dhe as

përfundimtare, si dhe nuk dihej lloji dhe sasia e materialit të shpërndarë brenda për brenda MTI-së.

Konkluzioni

Përkundër përpjekjeve tona, ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse materialet harxhuese janë shpërndarë stafit të MTI në përputhje me sasinë e pranuar, pasi evidencat e ofruara, ishin konfuze dhe të pa qarta. Kontrollat e mangëta të evidencave mundësojnë që këto materiale të përdoren për qëllime tjera.

Rekomandimi nr. 4

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj :

- Forcimin e kontrolleve në lidhje me prokurimin.

3.3.2 Investimet Kapitale

Tek ndërtimi i Parkut Industrial në Drenas, Faza e tretë, vlera e kontratës €1,803,756 kemi identifikuar:

- Garancioni i ekzekutimit të punimeve përfshin periudhën prej 26.08.2008 deri 31.12.2008. Ky garacion nuk e ka mbuluar kohën e ekzekutimit të punimeve në përputhje me Nenin 60 të LPP pasi që OE “Hidroterm” nuk ka mundur të kryejë punimet në pajtim me kohën e paraparë në kontratë. Punimet e papërfunduara nuk kanë qenë të mbuluara me një garacion tjetër.
- MTI nuk ka aplikuar penalet ndaj OE i cili është dashur të përfundojë punimet brenda 120 ditëve kalendarike pas nënshkrimit të kontratës. Nënshkrimi i kontratës është bërë me 26.08.2008, ndërsa edhe në kohën e ekzaminimit fizik në punishte me datë 18.05.2009 pas 260 ditëve kalendarike punët kanë qenë të pa përfunduara.
- Meqenëse kriter bazë për shpalljen e fituesit ka qenë “Oferta ekonomikisht më e favorshme” OE “Hidroterm” ka fituar kontratën duke u poentuar më së larti, mirëpo ky OE ka dështuar të përfundojë punimet në përputhje me ofertën e paraqitur. Gjatë fazës së ofertimit, tre ofertues të tjerë kanë pasur çmime më të lira, ku dallimi në mes të fituesit dhe ofertuesit më të lirë OE “Alfa.i.&Kag asfalt” është €244,675 .

Konkluzioni :

Mos përmbushja e kontratës nga OE në përputhje me kushtet e kontratës, si dhe mos aplikimi i penaleve nga MTI, sipas Nenit 12 të kontratës, i cili parasheh që për çdo ditë vonesë në realizimin e punimeve, gjohën prej 1/1000 të vlerës totale së kontratës, flet qartë për keqmenaxhim të projektit dhe dëmtim të buxhetit të Kosovës.

Rekomandimi nr. 5

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj :

- Të aplikohen gjambat ndaj OE për mos përmbushjen e kontratës, në përputhje me Nenin 12 të kushteve të kontratës.
- Të ushtrohet një kontroll i fuqishëm në zbatueshmërinë e kërkesave të LPP-së, si në procedurat e zhvillimit të aktivitetit prokurues ashtu edhe në përmbushjen e kontratave.

3.4 Obligimet e Papaguara

- Te kontrata me numër MTI 204-08-043-1.3.6, obligimi i papaguar i Faturës me Nr. 059/08 në vlerë €9,859 i datës 19.09.2008, i prezantuar në PF, ende kishte mbetur i pa paguar deri në fund të muajit Maj, gjatë kohës sa ne ishim në Auditim.
- MTI nuk i kishte prezantuar në PF detyrimet e pa paguara në vlerë prej €5,472, pa i llogaritur kamatat dhe shpenzimet tjera, pasi që gjatë vitit 2008 kishte humbur kontestin gjyqësor me ish zyrtarin e inspeksionit të larguar nga puna me 23.02.2007.
- MTI nuk e kishte zbatuar në plotni aktvendimin për lejimin e përmbartimit të Gjykatës Komunale Prishtinë Nr.783/08 në lidhje me kthimin në punë të ish zyrtarit të inspeksionit, pasi që MTI nuk e kishte bërë ekzekutimin e pagesës në vlerë prej €358 në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në llogari të të dëmtuarit.

Konkluzione

Vonesat e shkaktuara nga MTI-së në kryerjen e obligimeve ndaj OE, janë në kundërshtim me LMFPF dhe kushtet e kontratës, po ashtu vonesat në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore i shkaktojnë dëme shtesë buxhetit të Kosovës.

Kontrollet e brendshme financiare të MTI-së kanë dështuar në përmbushjen e obligimeve ligjore. MTI ka pasur mbetje buxhetore mbi 30% në fund të vitit, ndërsa nuk ka paguar obligimet të krijuara tre muaj para përfundimit të vitit,

Rekomandimi nr. 6

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj :

- Të gjitha pagesat të kryhen me kohë dhe në përputhje të plotë me LMFPF dhe kushtet e kontratës.
- Ekzekutim të plotë dhe me kohë të të gjitha vendimeve gjyqësore të cilat e marrin formën e prerë, në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti i Kosovës përmes krijimit të shpenzimeve tjera të pa arsyeshme.

3.5 Menaxhimi i pasurive

Të gjeturat:

- MTI nuk kishte arritur që të bëjë regjistrimin dhe mirëmbajtën e të gjitha pasurive në përputhje me IA 2005/11. Në mungesë të këtyre evidencave te plota, MTI nuk ka arritur që të prezantojë pasuritë në Pasqyrat Financiare të vitit 2008.
- Gjatë vitit 2008 nuk është bërë inventarizimi i pasurive, madje as deri në fillim të qershorit 2009 kur ne ishim në auditim nuk kishin përfunduar inventarizimin.
- Gjatë vitit 2008 në MTI ka pasur lëvizje të stafit në numrin 48. Nga ky numër i të larguarve, 24 prej tyre nuk janë shkarkuar nga pasuritë që kanë pasur në përdorim, 12 as që kanë qenë fare të ngarkuar, kurse 12 prej tyre janë shkarkuar.

Konkluzioni

Prezantimi i pasurive nuk është në pajtim me UA 2005/11 mbi “Menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive qeveritare”. MTI nuk posedon një regjistër definitiv mbi pasuritë dhe inventarizimi i pasurive është bërë në mënyrë të pjesshme. Raportimi i vlerësimit të pasurive financiare është i pasaktë. Si pasojë e kësaj mospërputhje ekziston rreziku i rritur i ekspozimit ndaj humbjes, shpërdorimit dhe keqpërdorimit të pasurive publike.

Rekomandimi nr. 7

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj :

- Regjistrimin e menjëhershëm të të gjitha pasurive, në pajtim me kërkesat që dalin nga Udhëzimi Administrativ 2005/11, si dhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore për punëtorët e pa shkarkuar me pasuri.

4. Sistemi i Kontrollit të brendshëm

Sistemet e Kontrolleve të Brendshme janë strukturë organizative, procedura operative, dhe praktika administrative të përshtatura nga të gjitha nivelet e Menaxhmentit, që ofrojnë siguri të arsyeshme që programet dhe aktivitetet administrative janë duke u zhvilluar në mënyrë efektive në pajtim me objektivat e parapara.

Kontrolli i Brendshëm është një proces i integruar që është i ndikuar nga Menaxhmenti i Entitetit dhe personeli, si dhe është i dizajnuar që të ofroj siguri të arsyeshme që në përputhje me misionin e entitetit, objektivat kryesore në vijim janë duke u arritur:

- Kryerja e aktiviteteve operative në mënyrë të duhur, etike, ekonomike, efikase dhe efektive
- Përbushja e detyrave që janë në përgjegjësi;
- Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloret në fuqi;
- Ruajtja e resurseve nga humbjet .

Rezultatet e auditimit tonë të prezantuara më lartë, kanë identifikuar mangësitë në kontrollin e brendshëm në kuadër të Ministrisë. Këto janë të rëndësishme që të adresohen me qëllim që të ofrohet siguri e arsyeshme që aktivitetet operative janë duke u kryer në mënyrë të efektshme.

Rekomandimi nr. 8

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të sigurojë:

- Forcimin e kontrolleve të brendshme, veçanërisht në çështjet që kanë të bëjnë me eliminimin e dobësive të identifikuara më lart.

5. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është përgjegjës për të verifikuar që menaxhmenti dhe sistemet e kontrollit përputhen me specifikat buxhetore, objektivat, rregullat dhe standardet, si dhe me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. Auditimi i brendshëm kryen teste të pavarura, auditime të sistemit, auditime të performansës, auditime të TI dhe çdo lloj tjetër të auditimeve që konsiderohen si të nevojshme për të siguruar përputhjen e menaxhimit me rregullat dhe rregulloret e organizatës. Procesi i auditimit të brendshëm duhet të themelojë një mekanizëm të duhur të prapa veprimit mbi të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm në raport me rregullat financiare dhe rregulloret tjera.

Gjatë vitit 2008, MTI nuk kishte arritur që ta ketë të konsoliduar sa duhet NJAB, pasi që nga Marsi deri në Qershor NJAB kishte mbetur pa Auditor të Brendshëm. Gjatë pjesës së dytë të vitit, MTI në kuadër të Njesisë së Auditimit të Brendshëm kishte pranuar një Auditori të ri, i cili edhe pse kishte arritur që të përgatitë dy raporte të auditimit, nuk ka arritur që të konsolidojë NJAB në atë masë që të mund të mbështetemi në punën e tij.

Rekomandimi nr. 9

Rekomandojmë Ministrin e MTI-së që të siguroj :

- Që NJAB-i t'i planifikojë dhe kryej aktivitetet e saja vjetore bazuar në vlerësimin e rrezikut.
- Zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionit. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të **mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar** kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në

mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restrikcione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar

Shtojca II: Komentet e MTI-së dhe Vlerësimet e ZAP

Aneksi	Komentet e MTI	Vlerësimet e ZAP
1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	<p>Pajtohemi me të gjeturat dhe konkluzionin. Ka një pjesë të arsyeve Objektive dhe Subjektive pse nuk është shfrytëzuar buxheti mbi 69%, të cilat mundë të merren për Raportin përfundimtar:</p> <p>Objektive:</p> <ol style="list-style-type: none"> Aprovimi i Buxhetit 2008 me një vonesë prej 3 muajve dhe shfrytëzimi i tij nga 01.04.2008. Mbyllja afatit të zotimeve për Investimet kapitale në pjesën e parë të muajit Nëntor, për mallra e shërbime në pjesën e dytë të muajit Nëntor, Mbyllja afatit të pagesave me 22 Dhjetor 2008. <p>Subjektive:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pagat dhe Mëditjet - mbetja ka rrjedhë se nuk është kompletuar Stafit sipas Organogramit dhe planifikimit të Buxhetit, si në Agjencinë për regjistrimin bizneseve (ARBK), Agjencinë për Promovimin investimeve (APIK), etj. Mallrat dhe shërbimet - mbetja ka rrjedhë si pasojë: <ul style="list-style-type: none"> E ndërprerjes së Kontratës për mirëmbajtje të Serverëve me kompaninë Toka, në ARBK, Në Agjencinë për Standardizim mos përmbushja e nevojave të realizimi i standardizimit dhe akreditimit Kosovar, mos anëtarësimi në ISO/IEC CEN/CENELEC si pasojë e mos anëtarësimit të Kosovës në OKB. Mbetja në shume prej €180,000 hasja në vështirësi në procedure të prokurimit për fusha të veçanta si Projekti i Ngritjes së Infrastrukturës së Cilësisë në Njësinë e Akreditimit, Në APIK nuk janë realizuar Publikimet e parapara dhe nuk janë realizuar udhëtimet dhe konferencat për investime, Në Inspektion mos lejimi i mjeteve nga Sekretari Permanent, duke mos nënshkruar kërkesat e dorëzuara me kohë, Në Departamentin e Metrologjisë mos lejimi i mjeteve nga Sekretari Permanent duke mos nënshkruar kërkesat e dorëzuara me kohë, Në Departamentin e Ndërtimtarisë për shkak të ndryshimit-lëvizjeve të stafit, mos lejimi i vizitave të punës të planifikuara në Slloveni nga Sekretari 	<p>MTI është pajtuar me konkluzionet e auditorit. Në vijim nga Entiteti kryesisht jepen shpjegime të arsyeshmërisë së mos realizimit të buxhetit të aprovuar. Presim nga MTI që të ketë planifikim më të mirë të buxhetit në vitet në vijim.</p>

	<p>Përgjithshëm, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në Departamentin e Tregtisë për shkak të mos lejimit nga Sekretari i përgjithshëm të kërkesave për realizimin e projekteve të planifikuara si Organizimi i Tryezës për Politikën Tregtare, vizita në vende anëtare të CEFTES, në Turqi për liberalizim të tregut, etj. <p>c) Investimet kapitale:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në Departamentin e Metrologjisë ka dështuar për Lot-in e tretë projekti i “Zhvillimit të fushave të reja të Metrologjisë” për shkak të Ofertuesve jo të kompletuar konform kriterëve të kërkuara nga Zyra e Prokurimit, Në Departamentin e Ndërtimit ka dështuar projekti i Hartimit të Projektit Ideor dhe Kryesor për “Institutin e Ndërtimit”, sepse nuk ka pasur ofertues të cilët kanë plotësuar kërkesat e tenderit, etj 	
2. Pasqyrat financiare	<p>Pajtohemi me konkluzionin e të gjeturat Nuk kanë qenë të regjistruara pasuritë në PF me datën 31.12.2008. Rekomandimi Nr.1 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet</p>	MTI është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionin. Ne e mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.
3.1.1 Te hyrat nga Departamenti i Tregtisë (DT)	<p>Nuk pajtohemi me të gjeturat në tërësi. Të hyrat - shuma prej €31.350 është e specifikuar nga Departamenti i Tregtisë (DT) sipas Kodeve ekonomike-kategorive përkatëse si dhe në SIMFK (Librin Kryesor) dhe Tabela nr 1. në MTI nuk figuron. Dëshmi: 1. Lista e Subjekteve për pagesat e kryera gjatë vitit 2008 paraqitur nga DT (gjitha aplikacionet e subjekteve kanë edhe fletëpagesat nga Banka). Gjithsejtë të hyrat (shuma e të gjitha kodeve të specifikuara) janë €123,100 2. Raporti i pranimeve sipas programeve. PF, të hyrat e regjistruara nga DT dhe SIMFK (Libri Kryesor) nuk barazohen për €2,050 sepse: DT-së taksën e licencës të paguar nga Subjekti “FITORJA” në shumë prej €2,000 e ka regjistruar në Dhjetor 2007 kur edhe është paguar me datën 28.12.2007, kurse Departamenti i Financave në SIMFK (librit kryesor) e ka regjistruar në Janar 2008 në shumë prej €2,000 duke u bazuar në Extraktin Nr. 602 dt. 10.01.2008. €50 tjera kanë shkuar në Zyrën për pronësi industriale me ekstrakt.</p>	<p>Tabela Nr.1 është përgatitur nga të dhënat e SIMFK (Librit Kryesor), si dhe evidencat elektronike të krijuara nga Departamenti i Tregtisë, të cilat na janë ofruar gjatë auditimit. Dëshmitë e ofruara me anë të komenteve, nga DT nuk e ndryshojnë të gjeturën tonë.</p> <p>Mbesin konstatimet e auditorit, dhe presim zbatimin e rekomandimeve.</p>

3.1.2 Të hyrat nga Zyra për Pronësi Industriale (ZPI)	Pajtohemi me të gjeturat Gjatë vitit 2009 janë proceduar lëndët e mbetura nga vitit 2008, ku edhe ka vazhduar regjistrimi sipas muajve veç e veç i të hyrave, i cili ka ndryshuar gjendjen e gjetur nga Auditori Përgjithshëm dt. 31.12.2008. Sipas Regjistrimit të bërë nga ZPI të hyrat në vitin 2008 janë në shumë prej €629,045 kurse sipas Free Balancit të hyrat janë në shumë prej €632,115 ku shihet se diferenca është - €3,070. Rekomandimi Nr.2 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet dhe realizohet.	MTI është pajtuar me të gjeturën tonë, në vijim nga Entiteti kryesisht jepen shpjegime të arsyeshmerisë se ndodhjes së të gjeturës. Ne e mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.
3.2 Pagat dhe Mëditjet	Pajtohemi me të gjeturat Sipas Ligjit do të veprohet për mundësin e kthimit të pagesave të tepërta MTI-së. Rekomandimi Nr.3 i Auditorit të përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet dhe realizohet.	MTI është pajtuar me të gjeturat Ne e mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.
3.3.1 Shpenzimet materialeve furnizuese të zyrës	Pajtohemi me të gjeturat. Materialet e harxhuara (Tonerët dhe Letra) si e hyrë në sasi është e regjistruar e vërtetuar në Prokurim, e cila ka dorëzuar në tërësi zyrtarit të Depos, i cili edhe e ka pranuar. Nga zyrtari i depos është shpërndare stafit të MTI-së sasia më e madhe, por ka mbetje të Saldos me 31.12.2008 që është përcjellur për vitin 2009. Evidenca e tij nuk është e qartë në momentin e prezantuar të Auditori, por pas shikimit të dokumentacionit është konstatuar kjo gjendje: Sipas të dhënave kemi blerë gjithsej 2286 RISA Letër, ndërsa kemi patur dalje 1740 RISA, që d.t.th se në fund të vitit kemi pasur rezerva në depo 546 RISA Letër . MTI ka një veprimtari të gjerë, që synon me politikat e saja të bëhet zhvillimi ekonomik i Republikës së Kosovës, dhe kjo përmes Agjensioneve, Departamenteve, etj. Sektorë të saj, të cilat duhet prezantuar me raporte, strategji, projekte, etj etj, që krijon një shpenzim të materialit zyrtar (letër, toner, etj.) shumë më shumë se Organizatat tjera buxhetore. Rekomandimi Nr. 4 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet dhe realizohet.	MTI shihet qartë se është pajtuar me të gjeturën tonë. Ne e vlerësojmë ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme nga menagjimenti i MTI-së në drejtim të përmirësimit të gjendjes rreth furnizimeve me materiale të zyrës. Ne e mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.
3.3.2 Investimet Kapitale	Nuk pajtohemi me të gjeturat dhe konkluzionin . 1. OE ka siguruar punimet në përputhje me kushtet e kontratës Faza III-të. Dëshmi: Certifikatë sigurimi për Garancinë e Kontratave, Nr. polices 972. 2. Penalet ndaj OE nuk janë aplikuar në vitin 2008, pasi si MTI kemi marrur Vendimin dhe Njoftimin e OE për arsyeshmërinë e ditëve të humbura të punës -	1. Dëshmia e paraqitur nga MTI nuk e ndryshon të gjeturën tonë, pasi që kjo Certifikatë sigurimi për Garancinë e Kontratave, me Nr. polices 972 mbulon

	<p>ndërprerjen e punimeve.</p> <p>Njoftim: Në vitin 2009 për të gjitha vonesat e pa arsyeshme OE do të ketë penale sipas nenit 12 të kontratës për çdo ditë vonese 1/1000 e vlerës totale të kontratës, të llogaritura nga MTI, Prokurimi dhe Agjencia për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme.</p> <p>3. Pse është pranuar ofertuesi më i lartë.</p> <p>Dosja e tenderit për zgjedhjen e OE për ndërtimin e fazës së III të Parkut në Drenas, nuk ka pas të bëj me çmimin më të ulte, mirëpo përzgjedhja është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit që thotë “Oferta ekonomikisht më e favorshme”</p> <p>Komisioni duke u bazuar në kriteret e përzgjedhjes dhe nën kriteret e dhënies së kontratës (çmimi 50% , metodologjia 20% , plani dinamik 10% , referencat 10% , kapaciteti teknik 10%) i ka rekomanduar zyrës së prokurimit të MTI-së, si OE më të suksesshëm kompaninë “Hidroterm”</p> <p>Rekomandimi Nr. 5 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet, me paraqitjen e shkeljeve.</p>	<p>periudhën prej 26.08.2008 deri 31.12.2008. Duke e ditur se ka pas vonesa në kryerjen e punimeve neve nuk na është ofruar nga MTI garancion tjetër i cili tregon se pjesa tjetër e punimeve pas 31.12.2008, ka qenë e mbuluar me ndonjë garancion tjetër.</p> <p>2. Gjatë vitit 2008 OE nuk i ka përfunduar punimet brenda 120 ditëve kalendarike në pajtim me Nenin 32 të kontratës. Arsyeshmëria e ditëve të humbura të OE nuk është në përputhje me kushtet e përgjithshme të kontratës Pika 9.</p> <p>3. Përzgjedhja e OE si fitues sipas kriterit ekonomikisht më i favorshëm, është bërë në pajtim me LPP, por mos zbatimi i Penaleve nga MTI, ndaj OE për vonesat e shkaktuara, flet qartë për menaxhimin jo të mirë të projektit.</p> <p>Mbesin konstatimet e auditorit, dhe presim zbatimin e rekomandimeve.</p>
3.4 Obligimet e pa paguara	<p>Pajtohem me të gjeturat – të pika e I-rë.</p> <p>Pagesa e Faturës Nr.059/08 në vlerë prej €9,859 e datës 19.09.2008 nuk është bërë. Mjetet e planifikuara dhe zotuar në vitin 2008 për këtë qëllim prej €10,000 nuk janë shfrytëzuar dhe kanë shkuar në suficit, edhe sot është e pa paguar. DT në afatin më të shkurtër duhet bërë kërkesën për zotimin e mjeteve dhe për pagesën e borxhit të mbetur nga viti 2008, nga buxheti i vitit 2009.</p>	<p>MTI është pajtuar me të gjeturën tonë në pikën e I-rë.</p> <p>Ndërsa të pika e II-të dhe III, MTI nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që të ndryshojmë të gjeturën tonë.</p>

	<p>Nuk pajtohem me të gjeturat – te pika e II-të dhe III</p> <p>Lënda për ekzekutimin e Aktvendimit për lejimin e përmbarimit janë procedurë pasi nga MTI - përmes Zyrës Ligjore kanë shkuar në Ministrinë e Drejtësisë, e cila ka bërë përgjigje në padinë lëndën C1 Nr.439/08 me dt. 27.05.2009.</p> <p>Dëshmi: Shkresa e MTI - Dep.Ligjor 04 Nr.prot.2736 dt.23.06.09, etj.</p> <p>Gjykata duhet bërë ndalesën direkt nga llogaria, pas kalimit të afatit prej 7 ditëve.</p> <p>Rekomandimi Nr. 6 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet dhe realizohet.</p>	<p>MTI nuk e ka zbatuar në plotni Aktvendimin për përmbarim me Nr. E 783/08, e cila e detyron MTI që të kthejë në punë ish punëtorin e suspenduar, të bëjë kompensimin e të ardhurave që nga dita e largimit nga puna, deri në ditën e kthimit në punë, si dhe të paguajë paditësit shpenzimet e procedurës gjyqësore në vlerë prej €358. Çdo vonesë në zbatimin e vendimeve gjyqësore do të krijojë MTI-së shpenzime shtesë.</p> <p>Ne e mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.</p>
<p>3.5 Menaxhimi i Pasurive</p>	<p>Pajtohem me të gjeturat dhe konkluzionin.</p> <p>MTI ka emëruar Komisionin për regjistrimin e mjeteve themelore - inventarit dhe shikimit të dokumentacionit për furnizim.</p> <p>Komisioni ka filluar regjistrimin, por nuk e ka përfunduar me 31.12.2008.</p> <p>Ka vazhduar punën për regjistrim në vitin 2009 dhe ka përfunduar me datën 26.02.2009.</p> <p>MTI ka emëruar edhe Komisionin për regjistrimin e të gjitha Paisjeve dhe Inventarit, me datën 05.12.2008. Komisioni ka filluar regjistrimin por nuk e ka përfunduar me 31.12.2008.</p> <p>Me datën 26.02.2009 nga UD - Sekretarit të Përhershëm në MTI, u lëshua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.567 të datës 05.12.2008, ku bëhet ndërrimi i një anëtarit të komisionit. Komisioni ka vazhduar regjistrimin dhe ka kryer me datën 28.04.2009.</p> <p>Arsyetim: MTI ka pas në shfrytëzim objektin me qira. Qeveria e Kosovës sipas vendimit të sajë ka filluar ndërtimin – rindërtimin e disa objekteve prona shtetërore, njëra ndër to është edhe ndërtimi - rindërtimi i objektit të menzës së studentëve të Fakultetit Teknik për nevojat e MTI-së, ku edhe pritej sipas vendimit të MSHP bartja e shpejtë para vitit të ri 2009 e të stafit të MTI-së. Por duke pritur për çdo ditë, kjo</p>	<p>MTI është pajtuar me të gjeturën dhe konkluzionin tonë, në vijim nga Entiteti kryesisht jepen shpjegime të arsyeshmërisë së ndodhjes së këtyre të gjeturave.</p> <p>Ne e mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.</p>

	<p>bartje ndodhi me 31.01.2009 e cila ishte shumë e koklavitur - e përzërë, ku edhe regjistrimi i filluar nuk u krye në tërësi nga Komisioni 31.12.2008 por vazhdoi në vitin 2009 dhe përfundoi me datën 28.04.2009.</p> <p>PF për Pasuritë për vitin 2008, kanë përfunduar pra në vitin 2009.</p> <p>Rekomandimi nr. 7 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet.</p>	
4. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm	<p>Pajtohem me të gjeturat.</p> <p>Rekomandimi Nr. 8 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet.</p>	Ne mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.
5. Auditimi i brendshëm	<p>Pajtohem me të gjeturat.</p> <p>Rekomandimi Nr. 9 i Auditorit të Përgjithshëm nga MTI siguron se do të aplikohet.</p>	Ne mirëpresim gatishmërinë e juaj për zbatimin e rekomandimit.

